



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 25 shtator 2023
Nr. Ref.: RK 2269/23

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI56/23

Parashtrues

Lendita Zherka

Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktit të paspecifikuar të autoritetit publik

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Lendita Zherka, me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e akteve të paspecifikuara të autoriteteve publike.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së akteve të paspecifikuara të autoriteteve publike, përmes së cilave pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkëlur të drejtat dhe liritë themelore të saj të garantuara me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 26 [E Drejta e Integritetit Personal] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).
4. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata vendosjen e masës së përkohshme ndaj aktit të paspecifikuar të autoritet publik.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), si dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).
6. Me 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 23 shkurt 2023, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën e saj, të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) e pranoi më 3 mars 2023.
8. Më 7 mars 2023, Kryetarja përmes Vendimit [Nr. GJR. KSH56/23] caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese) Radomir Laban dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
9. Më 9 mars 2023, Gjykata njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 21 qershor 2023, Gjykata kërkoj nga parashtruesja e kërkesës që në mbështetje të kërkesës së saj të dorëzojë në Gjykatë vendimin e kontestuar.
11. Më 3 korrik 2023, parashtruesja e kërkesës përmes një shkresë informoi Gjykatën se ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Themelore në Gjakovë për ta marr vendimin e kontestuar si dhe kërkoj shtyrje të afatit deri me 5 korrik 2023.
12. Deri në këtë datë, parashtruesja e kërkesës nuk ka dorëzuar dokumentin e kërkuar.

13. Më 31 gusht 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve të rastit

Marrëveshja mbi kredinë dhe ristrukturimi i saj

14. Më 27 qershor 2007, R.Zh., si përfaqësues i “Reshati Impex” në cilësinë e kredimarrësit dhe parashtruesja e kërkesës në cilësinë e bashkëshortes së kredimarrësit bashkë me Xh.Zh., dhe B.Zh në cilësinë e garantuesve, nënshkruan Marrëveshjen për Kredinë [nr.200627713] me Raiffiesen Bank (në tekstin e mëtejme: Kreditori) si dhe Marrëveshjen mbi Hipotekën [nr.200627713/H], për shumën 1, 000, 000 euro. Ndërsa, më 11 qershor 2009, palët nënshkruan Aneksin nr. 2 për ristrukturimin e kredisë [nr. 200627713]; [nr. 200637146] dhe [nr. 200654716] në vlerë prej 409.700,00 euro me [nr. 40000205].
15. Më 13 maj 2008, palët nënshkruan Marrëveshjen mbi Linjën e Kredisë [nr.200644476] për shumën prej 140,000 euro, ndërsa me 20 maj 2008 nënshkruan marrëveshjen mbi hipotekën [nr.200644476/H]. Në vazhdim, palët më 12 gusht 2008 dhe 11 qershor 2009 nënshkruan shtojcën nr. 2 dhe nr. 3 të Marrëveshjes me numër 200644476.

Propozimi për përmbarim dhe procedura përmbarimore

16. Më 20 korrik 2010, Kreditori, me arsyetimin se kredimarrësi nuk i është përmbajtur marrëveshjeve të sipërcituara, paraqiti propozimin për përmbarim në Gjykatën Komunale në Gjakovë duke kërkuar që të caktohet përmbarimi për shitjen, zbrazjen dhe dorëzimin e paluajtshmërive [nr. 2078/1]; [nr. 136/3]; [nr. 2078/3] me pronar Xh.Zh., R.Zh., R.Zh, si dhe banesën me pronar B.Zh., me qëllim të realizimit të kërkesës së tij ndaj kredimarrësit.
17. Më 20 korrik 2010, Gjykata Komunale në Gjakovë nxori Aktvendimin [E.nr.1029/2010] përmes të cilit lejoi përmbarimin sipas propozimit të kreditorit bazuar në dokumentin përmbarimor dhe marrëveshjet e lidhura mes kreditorit dhe kredimarrësit, për kthimin e borxhit-kredisë në shumën prej 633, 738, 54 euro, me kamatë ligjore dhe shpenzime të përmbarimit.
18. Më 20 dhjetor 2013, Gjykata Themelore në Gjakovë duke vendosur sipas kërkesës së Kreditorit për caktimin e konkluzionit për paluajtshmëritë, nxori Konkluzionin [E.nr.1029/10] mbi shitjen publike të paluajtshmërive [nr. 2078/1]; [nr. 136/3]; [nr. 2078/3] me pronar Xh.Zh., R.Zh., si dhe banesën me pronar B.Zh., me qëllim të realizimit të kërkesës se kreditorit ndaj kredi marrësit.
19. Nga shkresat e lëndës vërehet se në rastin konkret janë ndërmarrë edhe disa hapa tjerë procedural lidhur me zhvillimin e procedurës përmbarimore duke përfshirë nxjerrjen e konkluzionit për shitjen e paluajtshmërive përmes caktimit të ankandit publik dhe përsëritjen e tij me 16 shtator 2016 deri në shitjen përfundimtare të paluajtshmërive përmes konkluzionit të 16 shtatorit 2016 për çmimin e përgjithshëm prej 128.966.67 euro.
20. Më 27 tetor 2016, Përmbaruesi Privat nxori Urdhrin [P.nr. 634/14] përmes të cilit (i) i shiti kreditorit pronat [nr.2078/1]; [nr.136/3]; [nr.2698/07]; [nr.2078/3] me pronar Xh.Zh., R.Zh., dhe B.Zh; (ii) detyroi të i lirojnë dhe të i dorëzoje paluajtshmëritë në posedim të kreditorit; si dhe (iii) obligoi Shërbimin pronësorë juridik pranë Drejtorisë Komunale për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë në Komunën e Gjakovës që pronat e lartcekura të i regjistroj si prona në emër të kreditorit.

21. Më 29 tetor 2021, Përmbaruesi Privat përmes Konkluzionit [P.nr.634/14] obligoi Xh.Zh., R.Zh., dhe B.Zh., për lirimin e paluajtshmërive në bazë të dokumentit përmbarimor për shitjen e paluajtshmërive dhe në bazë të konkluzionit për shitje të 16 shtatorit 2016, ose në të kundërtën përmbarimi i kërkesës së kreditorit do të bëhet në mënyrë të dhunshme.
22. Parashtruesja e kërkesës nuk ka dorëzuar në Gjykatë aktin e autoritetit publike të cilin pretendon që e konteston.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se me vendimet e paspecifikuara të autoriteteve publike, asaj i është shkëlur e drejta e saj e garantuar me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 26 [E Drejta e Integritetit Personal] të Kushtetutës.
24. Në kërkesën e saj parashtruesja e kërkesës thekson se *“Aktvendimi E.nr. 1029/10 i 20 korrikut 2010, Vlerësimi kushtetues i vendimit ku unë, Lendita Qarri, linçohem, hiqem nga pala garantues e marrëveshjes së kreditore, kredia është marrë në vitin 2007, dhe ligji i aplikueshme është Ligji i Detyrimeve i vitit 1978, asnjë marrëveshje hipotekore nuk është e ligjshme. pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve, vlen bashkëpronësia dhe nëse është nënshkruar nga vetëm njëri prej bashkëshortëve, kontrata është e rrezueshme, relative, nul. Diskriminimi gjinor.”*
25. Parashtruesja e kërkesës tutje thekson se *“Nuk jam njoftuar asnjëherë zyrtarisht, si palë - garantuese e kredisë dhe në çdo procedurë përmbarimore gjyqësore dhe gjithashtu nga përmbaruesi privat Gjokë Radi, jam linçuar dhe hequr ligjërisht si pala garantues e marrëveshjes së kredisë.”*
26. Parashtruesja e kërkesës tutje thekson se *“Këtu në këtë rast unë si Individ nuk jam prekur në mënyrë direkte, por në mënyrë indirekte nga një Aktvendim E.nr.1029/2010, i institucionit gjyqësor të Kosovës”.*
27. Parashtruesja e kërkesës në mbështetje të pretendimeve të saj *“Sipas interpretimit të GJEDNJ-se, si parashtruese e kësaj kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së këtij Aktvendimi E.nr.1 029/201 0, jam viktime serioze e shkeljes se lirive dhe drejtave te njeriut nga autoriteti gjyqësor i Kosovës, gjegjësisht te Gjykatës Komunale Gjakove, sot Gjykata Themelore Gjakove . Kërkoj nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës përveç tjerash, kërkesën tone ta interpretojë edhe konform nenit 53 te Kushtetutës se Kosovës, pasi qe vendimet gjyqësore te GJEDNJ-se kane prioritet ndaj ligjeve dhe akteve tjera nënligjore të institucioneve gjyqësore të Republikës se Kosovës.”*
28. Parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që të shfuqizojë Aktvendimin E.nr.1029/10 të Gjykatës Themelore si dhe të vendosë masë të përkohshme.

Dispozitat relevante të Ligjit dhe Rregullores së punës

Ligji

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Rregullorja e punës

Rregulli 25
(Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve)

[...]

2) *Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:*

h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

Rregulli 54
(Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës)

“54 (2) Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e jo e plotë ose e paqartë përkundër kërkesës ose kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësoj kërkesën; [...]”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

29. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës. Në këtë drejtim, sipas paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, Gjykata vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. Ndërsa, sipas paragrafit 7 i të njëjtin nen të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
30. Përtej kriterëve të përcaktuara më lart, në vlerësimin nëse parashtruesja e kërkesës i plotëson kriteret për vlerësimin e kërkesës së saj, Gjykata rikujton se neni 48 (Saktësimi i kërkesës) i Ligjit specifikisht detyron parashtruesit e kërkesave të qartësojnë saktësisht aktin konkret të autoritetit publik të cilin e kontestojnë dhe të qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri kushtetuese pretendojnë të jenë cenuar. Ndërsa, rregulli 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) i Rregullores së punës parasheh që kërkesa e parashtruesve duhet të përmbajë edhe: (a) emrin dhe adresën e palës që parashtron kërkesën; (b) emrin dhe adresën e përfaqësuesit/es për dorëzimin e dokumenteve, nëse ka; (c) autorizimin për përfaqësim; (d) emrin dhe adresën e palës, ose të palëve kundërshtarë, nëse janë të njohura, të cilave u dërgohen dokumentet; (e) mbrojtjen juridike të kërkuar; (f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve; (g) arsyetimin rreth pranueshmërisë dhe meritave të kërkesës; dhe (h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.
31. Në këtë kontekst, sipas paragrafit 4 të nenit 22 (Procedimi i kërkesës) të Ligjit, që parasheh se nëse kërkesa ose përgjigja në kërkesë nuk është e qartë ose e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, përkatësisht përgjigjen në kërkesë. Atëherë, kur palët përkatëse, nuk dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në Gjykatë, bazuar në rregullin 54 (Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës, Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, duke marrë parasysh që kërkesa është e

paplotë ose e paqartë, përkundër kërkesave të saj ndaj palës që të plotësojë apo qartësojë të njëjtën.

32. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se kërkesën e parashtrueses së kërkesës e kishte pranuar më 3 mars 2023. Duke marrë parasysh që kërkesa nuk ishte e kompletuar, më 21 qershor 2023, në pajtim me paragrafin 4, të nenit 22 të Ligjit, Gjykata i kërkoi parashtrueses së kërkesës që të plotësojë kërkesën e saj duke dorëzuar vendimin që e konteston para Gjykatës, respektivisht Aktvendimin [E.nr.1029/2010] të 20 korrikut 2010 të Gjykatës Komunale në Gjakovë, në mbështetje të kërkesës/pretendimeve të saj
33. Më 3 korrik 2023, parashtruesja e kërkesës përmes një shkresë informoi Gjykatën se ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Apelit për të marrë vendimin e kontestuar si dhe kërkoi shtyrje të afatit deri më 5 korrik 2023. Megjithatë, edhe pas kësaj date, parashtruesja e kërkesës nuk kishte dorëzuar vendimin të cilin pretendon që e konteston para Gjykatës.
34. Gjykata vëren se në kërkesën e dorëzuar, parashtruesja e kërkesës në mënyrë shprehimore pretendon që e konteston Aktvendimin [E.nr.1029/2010] e 20 korrikut 2010 të Gjykatës Komunale në Gjakovë. Megjithatë, Gjykata thekson se nuk disponon aktvendimin e sipërcituar të cilin parashtruesja pretendon që e konteston, dhe rrjedhimisht Gjykata nuk mund të lëshohet në vlerësimin e kushtetutshmërisë së tij në mungesë të informatave mbi përmbajtjen e saktë të tij.
35. Në këtë aspekt, dhe duke marrë parasysh atë që u cek më lartë, Gjykata në bazë të Rregullores së saj të punës, mund të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër, meqë parashtruesja e kërkesës nuk ka dorëzuar vendimin që e konteston edhe pas kërkesës specifike të Gjykatës.
36. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës në thelb para Gjykatës kërkon që të shfuqizojë Aktvendimin E.nr.1029/2010 të Gjykatës Komunale në Gjakovë dhe të vendosë masë të përkohshme.
37. Gjykata thekson se parashtruesja e kërkesës nuk ka plotësuar kërkesën e Gjykatës që të dorëzojë Aktvendimin [E.nr.1029/2010] e 20 korrikut 2010 të Gjykatës Komunale në Gjakovë.
38. Gjykata thekson se ndonëse parashtruesja e kërkesës në kërkesën e saj ka specifikuar vendimin që pretendon se e konteston, por Gjykata në mungesë të përmbajtjes së plotë të vendimit, përveç që nuk mund të vlerësojë saktësinë e shifrës, datës dhe autoritetin që ka lëshuar vendimin e cituar si objekt kontesti para saj, nuk mundet të vlerësojë as kushtetutshmërinë, rezultatin apo efektet e tij në rrethanat e parashtrueses së kërkesës.
39. Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesave, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesave nuk i përgjigjen kërkesës së Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata i deklaron këto kërkesa si të paqarta dhe jo të plota, dhe si rezultat nuk i shqyrton pretendimet e parashtruesve të kërkesave (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës, [KI121/21](#), parashtrues *Bajram Hasani*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 23 shtatorit 2021, paragrafi 38; [KI135/21](#) *Isuf Musliuu*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 10 shtatorit 2021, paragrafi 35; dhe [KI101/21](#), *N.T.SH. Morina B*”, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 8 shtatorit 2021, paragrafi 36).
40. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtrueses së kërkesës nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejme, për shkak të moskompletimit të saj me dokumentacion mbështetës, ashtu siç kërkohet me nenet 22.4 dhe 48 të Ligjit

dhe me rregullin 26 (3) dhe 54 (2) të Rregullores së punës. Prandaj, Gjykata përfundon se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

Kërkesa për masë të përkohshme

41. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës, gjithashtu kërkon nga Gjykata që të nxjerrë vendim për vendosjen e masës së përkohshme ndaj aktit të paspecifikuar të autoriteti publik.
42. Megjithatë, ashtu siç është specifikuar si më lart, Gjykata konkludoi se kërkesa e parashtrueses të kërkesës refuzohet me procedurë të shkurtër, si jo e plotë.
43. Prandaj, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (2) të rregullit 45 (Vendimmarrja lidhur me kërkesën për masë të përkohshme) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtrueses të kërkesës për masë të përkohshme duhet të refuzohet, sepse e njëjta nuk mund të jetë objekt shqyrtimi, pasi kërkesa të refuzohet me procedurë të shkurtër, si jo e plotë. (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: KI107/19, me parashtrues *Gafurr Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 prillit 2020, paragrafët 88-90; KI159/18, me parashtrues *Azem Duraku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 majit 2019, paragrafët 89-91; KI19/19 e KI20/19, parashtrues *Muhamed Thaqi dhe Egzon Keka*, Aktvendim për papranueshmëri, i 26 gushtit 2019, paragrafët 53-55; dhe KI211/19, cituar më lart, paragrafi 83).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 27 dhe 48 të Ligjit si dhe rregullin 45 dhe 54 të Rregullores së punës, më 31 gusht 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani